


ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

MANUALI I STUDENTIT

Përgatitur nga:

Zyra e Karrierës, Kordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve në “Albanian University”


Tiranë, 2016



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

PËRMBAJTJA

Statusi i studentit.....	3
Organizimi i vitit akademik.....	3
Orari Mësimor.....	3
Llogaritja e Krediteve.....	3
Pjesëmarrja e studentëve në auditor.....	4
Kontrolli dhe vlerësimi i dijes.....	4
Organizimi i provimeve.....	5
Praktikat mësimore.....	5
Përfundimi i studimeve dhe diplomimi.....	5
Të drejtat dhe detyrat e Studentit.....	6
Këshilli Studentor.....	7
Organizimi i studimeve dhe titujt.....	8
Format e studimit.....	8
Programet e studimeve.....	9
Programet e studimit dhe titujt e diplomave në AU.....	9
Programet e integruara të studimit në fushën e Stomatologjisë, Farmacisë dhe Arkitekturës.....	9
Kohëzgjatja e studimeve në AU.....	9
Transferimi i studimeve.....	9
Rregullat e etikës për studentët e “Albanian University”.....	10
Vlerat themelore të “Albanian University”.....	10
Standartet etike të sjelljes së studentëve.....	10
Paraqitja në shkollë, mirësjellja dhe respekti.....	11
Procedurat disiplinore.....	12
Rekomandimet e mundshme të Komisionit të Incidenteve.....	13
Gjykimi nga Këshilli i Etikës.....	13
Burimet e Shfrytëzuara.....	15



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Statusi i Studentit

Një person fiton statusin e studentit me regjistrimin në AU dhe e humbet me marrjen e diplomës ose certifikatës përkatëse si edhe në raste të ndryshme të çregjistrimit të tij.

Një student në “Albanian University”, nuk mund të regjistrohet, njëkohësisht, në më shumë se një program studimi. Bëjnë përjashtim nga ky rregull, studentët ‘e shkëlqyer’ me notë mesatare maksimale nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë.

Organizimi i Vitit Akademik

Viti akademik ka 30 javë mësimore. Viti akademik ndahet në dy semestra, semestri i parë (I) dhe semestri i dytë (II). Secili semestër ka 15 javë mësimore.

Gjatë vitit të parë akademik organizohen tre sesione provimesh. Në vitet e tjera akademike organizohen pesë sesione provimesh të përcaktuara në kalendarin akademik të çdo programi mësimor dhe tre sesione diplomimi.

Gjatë vitit të dytë akademik ose semestrit të tretë të programit të “Masterit Profesional” zhvillohen tre sesione provimesh dhe tre sesione diplomimi.

Me vendim të Senatit Fakultetet kanë të drejtë të organizojnë edhe sesione të tjera të kufizuara të provimeve të bartura (riprovime), jashtë kalendarit akademik, para përfundimit të semestrit të parë dhe semestrit të dytë. Në këto provime studentët paraqiten kundrejt pagesës përkatëse.

Orari Mësimor

Ora mësimore zgjat 60 minuta.


Ngarkesa javore në auditor e studentit është 20-25 ore mësimore. Koha dhe auditori i zhvillimit të veprimtarisë mësimore pasqyrohet në orarin e mësimeve të shpallur nga Kancelari i Universitetit.

Orari është i detyrueshëm për studentët dhe pedagogët; ai hartohet mbi kritere pedagogjike, duke e shpërndarë ngarkesën mësimore në mënyrë të drejtë.

Llogaritja e Krediteve

Lëndët dhe modulet vlerësohen nga kreditet sipas parimit 1 kredit përfaqëson 25 orë pune mësimore. Në orët përcaktuese të kreditit përfshihen, përveç orëve mësimore në auditor, edhe koha jashtë auditorit e nevojshme për përvetësimin e materialit mësimor të dhënë, për përgatitjen e detyrave si dhe koha për punë të pavarur të studentit.

Kreditet mundet të fitohen, të sigurohen, të akumulohen ose të transferohen, nga studenti. Kreditet e një lënde fitohen, kur vlerësimi në atë lëndë është kalues. Nga brenda Universitetit



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

janë të transferueshme të gjitha kreditet e fituara; nga jashtë tij transferimi i krediteve kryhet sipas një rregulloreje të veçantë.

Kreditet e një lënde sigurohen kur studenti ka plotësuar kushtet e frekuentimit dhe nuk është vlerësuar jokalues në detyrat e testet e kontrollit të zhvilluara gjatë semestrit, por, për arsye të ndryshme ende nuk është provuar në atë lëndë ose vlerësimi i plotë pas provimit të dhënë të lëndës është jo kalues.

Kreditet e një lënde akumulohen kur studenti i ka siguruar, por ato ose nuk janë të mjaftueshme ose studenti nuk dëshiron të provohet në atë lëndë atë semestër apo atë vit. Këto kredite akumulohen edhe në rastin e ndërprerjes së studimeve për arsye vetjake ose familjare objektivisht të pranueshme.

Një vit akademik konsiderohet i kryer kur studenti ka fituar jo më pak se 60 kredite. Për përfundimin e studimeve të Ciklit të Parë studentit i duhet të fitojë minimalisht 180 kredite; për përfundimin e studimeve të Ciklit të Dytë studentit duhet të fitojë minimalisht 60, 90 ose 120 kredite, në varësi të programit të studimit; për përfundimin e studimeve të Ciklit të Tretë studentit duhet të fitojë 60 kredite teorike në rastin e doktoraturave dhe minimalisht 180 kredite në rastin e specializimeve të stomatologjisë.


Kreditet për çdo modul e lëndë pasqyrohen në planet mësimore te programeve te studimit.

Pjesëmarrja e studentëve në auditor

Frekuentimi i leksioneve dhe seminareve në të paktën 75 % të seancave është i detyrueshëm, si rregull, për sigurimin e krediteve dhe lejimin për t'u provuar në lëndën përkatëse.

Frekuentimi në punët laboratorike dhe praktikat profesionale dhe projektet në 100 % të seancave është i detyrueshëm, si rregull. Për studentët që kanë munguar me arsye në jo më shumë se 25 % të seancave të rregullta të punëve laboratorike dhe praktikave profesionale planifikohen deri në dy seanca plotësuese për çdo semestër dhe lëndë.

Studenti nuk pranohet në sesionin e parë të provimit të një lënde kur ka kryer më shumë se 25% mungesa në seancat mësimore të asaj lënde. Nëqoftëse ai ka kryer deri në 50 % mungesa në seancat mësimore të lëndës atëherë ai pranohet në sesionin e dytë. Nëse ka kryer mbi 50 % mungesa në seancat mësimore të lëndës shpallet përsëritës në atë lëndë.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Kontrolli dhe vlerësimi i dijes

Shkalla e vleresimit per përvetësimin e dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë (notat 1 deri 10), me pikë ose me përqindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (sistemi ECTS me shkronjat nga **A** deri **F**).

Vlerësimi me notë është i detyrueshëm, në kuptimin që përfundimi i një vlerësimi duhet të shprehet detyrimisht edhe me notë. Notat kaluese konsiderohen nga 5 e lart, pikët nga 41 e lart dhe shkronjat nga **A** deri **E**.

Studentët që përfundojnë vitin akademik me notë mesatare mbi 9 ose grumbullojnë mbi 90 pikë ose vlerësohen me të paktën shkronjën **B**, shënohen në nje liste te vecante qe administrohet nga Rektori. Nga kontigjenti i kësaj liste Rektori përzgjedh dhe propozon kandidatë të cilët vitin e ardhshëm akademik do të mund të përfitojnë bursa ose trajtime të ndryshme te privileguara.

Organizimi i provimeve

Në vlerësimin e dijes së studentit pedagogu, si rregull, mbështetet në përfundimet e kontrollit të vazhdueshëm si dhe në frekuentimin dhe pjesëmarrjen aktive në leksione, seminare, ushtrime, praktika, punë krijuese, punime të ndryshme dhe detyra kursi.

Provimet zhvillohen në sesionet e provimeve.

Studenti nuk lejohet të provohet në një lëndë për të dytën herë brenda të njëjtit sesion.

Provimi mund të organizohet për modulën (të përbërë nga disa lëndë) ose për lëndë të veçanta. Në rastin e modulit, vendoset notë për secilën lëndë përbërëse dhe nota e modulit është e mesatarja e ponderuar e tyre.


Kur student i është shpallur jokalues në njërin nga lëndët e modulit, student i vazhdon të paraqitet në provimet e lëndëve të tjera përbërëse të tij. Provimi i lëndës së mbetur jepet në sesionin pasardhës.

Me përfundimin e provimit, kryetari i komisionit të provimit ose pedagogu i lëndës e dorëzon fletën e provimit të plotësuar në Sekretarinë Mësimore brenda 7 ditësh nga zhvillimi i provimit.

Studenti ka të drejtë të përmirësojë rezultatet e jo më shumë se tre lëndëve në vit, në sesionin e dytë të provimeve.

Praktikat mësimore

Studenti është i detyruar të ndjekë praktikat mësimore të parashikuara në planin mësimor. Praktikant mësimore u nënshtrohen të gjitha rregullave të vendosura dhe vlerësimeve, njëjloj si për të gjitha detyrimet e tjera.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

Praktikat mësimore zhvillohen në institucionet e miratuara nga dekani dhe nën drejtimin e një pedagogu të caktuar nga Departamenti. Studenti detyrohet të zbatojë rregullat e institucionit ku kryen praktikën mësimore, të përcaktuara në Rregulloren e programit të studentit.

Përfundimi i studimeve dhe diplomimi

Me përfundimin e studimeve dhe fitimin e krediteve të nevojshme studentët kanë të drejtë të diplomohen në programin përkatës të studimit.

Diploma “*Bachelor*” mbrohet me provim formimi ose punim (tezë) diplome. Diploma “*Master*” mbrohet me punim diplome.

Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka dhënë provimin e formimit e ka mbrojtur punimin e diplomës, pajiset me diplomën përkatëse, Diplomë “*Bachelor*” ose Diplomë “*Master i Shkencave*”, “*Master Profesional*”


Për studentët që kanë përfunduar studimet me të gjitha notat dhjeta, diploma shoqërohet me certifikatën “*Medalje e Artë*”. Për studentët që kanë përfunduar studimet me mesatare mbi 9.5 diploma shoqërohet me certifikatën “*Student ekselent*”.

Në qoftë se origjinali i diplomës humbet ose dëmtohet deri në atë masë sa të bëhet i papërdorshëm, Universiteti nuk lëshon dublikatë. Universiteti mund të japë vetëm një vërtetim me fotografi të shoqëruar me listën e krediteve dhe notave të fituara. Vërtetimi është i barasvlefshëm me diplomën pasi të jetë nënshkruar nga Rektori, Dekani i Fakultetit dhe Kryesekretari.

Të drejtat dhe detyrat e Studentit

Gjatë kryerjes së studimeve në të gjitha ciklet Universitare, studenti gëzon të drejtat si më poshtë:

- të përfitojë nga procesi mësimor dhe të diplomohet, pasi të ketë shlyer të gjitha detyrimet e përcaktuara në planin mësimor të programit të studimit, si dhe te pagesave financiare;
- të kërkojë vlerësim të drejtë dhe objektiv të dijeve dhe të ecurisë së tij;
- të përdor infrastrukturën (salla leksionesh/seminarësh, laboratore, salla kompjuterash, bibliotekën, etj) që AU vë në dispozicion të procesit mësimor, si dhe të përfitojnë nga shërbimet mbështetëse që ofrohen për studentët në AU;
- Të nënshkruajë kontratën e shërbimi, në momentin e regjistrimit në AU.
- të kërkojë ndihmë a këshillim nga organet kompetente të Universitetit për njohjen e rregullave të tij dhe të mundësive që ky ofron për studime, specializime dhe kualifikime;
- Të shpreh opinionin e tij për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të AU;




ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

- Për studentët, që studiojnë në programet e studimit AU realizon sigurimin në një ndër shoqëritë e sigurimit, për risqe që mund të vinë për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të programit përkatës të studimit.
- të njihet me rezultatet e arritura prej tij dhe të kërkojë këshillim për zgjedhjen që duhet të bëjë për të fituar një diplomë të caktuar apo specializimin e dëshiruar;
- të mos lejohet të bëhen të njohura të dhënat e tij vetjake dhe përfundimet e tij gjatë viteve të studimit;
- të organizohet në shoqata studentore jopolitike, sipas akteve ligjore përkatëse;
- të marrë pjesë në veprimtari artistike, kulturore, sportive e argëtuese, të organizuara nga universiteti jashtë prçesit mësimor;
- të ndikojë në përmirësimin e procesit mësimor nëpërmjet formave demokratike të shfaqjes së vullnetit dhe të mendimit;
- të ankohet në mënyrë individuale ose kolektive, kur gjykon se procesi mësimor nuk zhvillohet në mënyrë të rregullt, kur njohuritë e ofruara nuk u përgjigjen nivelit të premtuar ose kur, si pasojë e metodës së përdorur në mësimdhënie, përfitimi i njohurive nuk është në shkallën e duhur;
- të bëjë kërkesë dhe ankesë kur mendon se vlerësimi për të nuk është i drejtë;
- të dëgjohet nga organet përkatëse të Universitetit, përpara se të merret masë ndëshkimore kundër tij.

Gjate kryerjes se studimeve ne te gjitha cikleve Universitare, studenti i nënshtrohet detyrimeve si më poshtë:

- të njohë me hollësi Rregulloren e Universitetit dhe detyrimet e tij. Universiteti nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre;
- të zbatojë të gjitha rregullat që rrjedhin nga Statuti dhe Rregullorja Akademike, si dhe nga çdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor për Arsimin e Lartë;
- të zbatojë normat shoqërore dhe rregullat e pranuar etiko-morale të procesit mësimor-educativ;
- të mbajë përgjegjësi për keqpërdorimin e mjediseve të Universitetit dhe të mjeteve didaktike të vëna në përdorim të tij; në rast se ka shkaktuar dëm material, detyrohet ta zhdëmtojë atë në masën që e gjykon dekanati;
- të shlyejë të gjitha detyrimet e përcaktuara në planin mësimor dhe në programet e lëndëve për të bërë të mundshëm fitimin e krediteve të nevojshme;
- të paguajë rregullisht tarifën e studimit.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Konsiderohen shkelje të rregullave të Universitetit të gjitha veprimet e kryera me dashje nga studenti, kur ato nuk përmbajnë elemente të veprës penale, përfshirë ato që përbëjnë cënim të normave shoqërore dhe etiko-morale, si:

- cënimi i dinjitetit të mësimit dhe të çdo punonjësi të Universitetit;
- aktet e rrugaçerisë ose sjellja e papëlqyeshme në mjediset e universitetit;
- dhënia e informacionit të gënjeshtërt për t'u përdorur në dokumentet e Universitetit;
- kopjimi, plagjiatura apo paraqitja si punë e vet e punës së një tjetri;
- blerja, shitja ose vjedhja e materialeve që përbëjnë pyetje a teza provimi;
- paraqitja në provim me emër të rremë ose paraqitja në provim e një personi tjetër për llogari të tij;
- dhënia ose marrja e informacionit me gojë a me shenja gjatë provimit.

Ndaj studentit që kryen veprime të tilla, merren masa disiplinore sipas dispozitave të Kodit të Etikës së Universitetit.

Këshilli Studentor

Në përmbushje të vetëorganizimit të jetës studentore, mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të tyre, si dhe për nevojat e përfaqësimit legjitim në strukturat e larta drejtuese të Universitetit, studentët krijojnë Këshillin Studentor në nivel Universiteti, i cili funksionon në përputhje me statutin e miratuar nga Asambleja e Këshillit Studentor.


Ky Këshill promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të AU, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve.

Këshilli Studentor zgjidhet çdo dy vjet nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi.

Këshilli Studentor shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të AU, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj

AU mbështet Këshillin Studentor dhe financon veprimtarinë e tij.

Studentët përfaqësohen gjithashtu në organet drejtuese të institucionit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve. "Albanian University" inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

vendimmarrje, organizimin e lirë, dhe shprehjen e mendimit të tyre. Ndër strukturat kryesore përmendim:

- *Këshilli i Studentëve* - realizon pjesëmarrjen e studentëve të çdo grupi në të tre Fakultetet dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese.
- *Senati Akademik* –ka 1 përfaqësues të studentëve, Kryetari i Këshillit Studentor të AU.
- *Komisioni për kurrikulat dhe Mësimin*, 1 përfaqësues të përzgjedhur nga Këshilli Studentor.
- *Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimin*, 1 përfaqësues të përzgjedhur nga Këshilli Studentor me votim.
- *Komisioni për Vlerësimin Institucional*, 1 përfaqësues të përzgjedhur nga Këshilli Studentor me votim.
- *Këshilli i Fakultetit* – 1 student përfaqësues për çdo program studimi, të përzgjedhur nga Këshilli Studentor me votim.

Senatorët studentë të Senatit Universitar në “Albanian University” shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm, si: për planet mësimore dhe programet e studimeve, rregulloret e studimeve etj. Ky mendim merret drejtpërdrejt nga takimet me studentët dhe nëpërmjet ankesave të paraqitura në Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve.

ORGANIZIMI I STUDIMEVE DHE TITUJT

Format e studimit

Format e studimeve në AU janë:

- a. studime me kohë të plotë;
- b. studime me kohë të zgjatur;


Studimet me kohë të zgjatur në AU ofrohen vetëm në programet studimit të ciklit të dytë “Master profesional”.

Realizimi i secilës nga format e mësipërme të studimit bëhet, sipas propozimit të AU, me miratim të Ministrisë përgjegjëse për arsim, në përputhje me kuadrin ligjor për arsimin e lartë në Shqipëri.

Programet e studimeve

AU ofron programe studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS).

Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

Programet e studimit dhe titujt e diplomave në AU

Programet e studimeve në AU organizohen në tre cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë.

Struktura e studimeve në cikle të ndryshëm studimi dhe titujt e diplomave të fituara me përfundimin e tyre janë në përputhje me përcaktimet përkatëse në Ligjin nr. 80/2015 si dhe aktet nënligjore në fuqi.

Programet e studimit, për çdo cikël studimi hartohen në përputhje me standartet e parashikuara në Kodin e Cilësisë të Arsimit të Lartë, në respektim të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe duke marrë në konsideratë kërkesat e tregut të punës, dhe punësimin e ardhshëm të studentëve.

Në AU me përfundimin e studimeve të cikleve përkatëse lëshohen diplomat e studimit, në varësi të cikleve të studimit: (1) Bacheror; (2) Master Profesional; (3) Master i Shkencave; (4) Doktoraturë; dhe (5) Specializime afatgjata.

Programet e integruara të studimit në fushën e Stomatologjisë, Farmacisë dhe Arkitekturës

1. AU ofron programe të integruara të studimit në Stomatologji, Farmaci, dhe Arkitekturë.
2. Programet e studimit në Stomatologji, Farmaci, dhe Arkitekturë realizohen me 300 ECTS, për një kohëzgjatje prej jo më pak se 5 vite akademike.


Kohëzgjatja e studimeve në AU

Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.

Transferimi i studimeve

AU ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve të studentëve midis programeve të të njëjtit cikël e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik në Fakultete të ndryshme brenda AU.

AU, u mundësohen studentëve njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve edhe nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit në AU.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe suplementi i diplomes

Studenti në përfundim të një programi studimi në AU, në zbatim të detyrimeve ligjore të parashikuara në nenin 91 të Ligjit Nr. 80/2015, ka të drejtë të pajiset me diplomën përkatëse e cila shoqërohet me suplementin e diplomës.

Suplementi i diplomës, është i detyrueshëm, për të tre ciklet e studimit, të ofruara nga “Albanian University”.

“Albanian University”, ka të drejtë që të pajisë studentin me diplomë, vetem pasi ajo të jetë regjistruar në regjistrin shtetëror të diplomave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve të Arsimit.

RREGULLAT E ETIKËS PËR STUDENTËT E “ALBANIAN UNIVERSITY

Vlerat themelore të “Albanian University”


Pedagogët, kërkuesit, personeli teknik-administrativ, studentët, si dhe çdo anëtar tjetër i universitetit, gjatë përmbushjes së detyrave dhe në kuadër të roleve e përgjegjësive që mbulojnë, individualisht apo kolegjialisht, duhet të respektojnë, mbrojnë dhe përkrahin vlerat themelore të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe veçanërisht:

- a) ndalimi i çdo diskriminimi të padrejtë;
- b) dinjiteti njerëzor;
- c) vlerësimi sipas kriterit të aftësisë;
- d) vlerësimi dhe respekti ndaj veçorive individuale dhe kulturore;
- e) përgjegjësia dhe njohja e detyrave ndaj komunitetit universitar;
- f) ndershmëria, integriteti dhe profesionalizmi;
- g) dija, cilësia e lartë, përkrahja e studimit dhe e kërkimit shkencor;
- h) barazia, paanshmeria, bashkëpunimi i ndershëm dhe transparencë.

Standartet etike të sjelljes së studentëve

Studentët duhet :

1. Të përmbushin detyrimet e tyre akademike me ambientin për të ndjekur zhvillimin intelektual të nevojshëm për realizimin me sukses të tyre.
2. Te krijojnë dhe ruajnë marrëdhëniet me bashkë studentët e tjere, duke zbatuar rregullat mbi etikën e statusit të studentit, ndershmërisë, respektit reciprok dhe mungesës së paragjyqimeve.
3. Te ruajnë prestigjin dhe emrin e mirë të rrethit akademik brenda dhe jashtë institucionit.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

4. Te zbatojnë me përpikëri detyrimet për një proces mësimor rezultativ, parashikuar në rregulloren e institucionit.
5. Te zbatojnë etikën e marrëdhënieve me pedagogët duke respektuar dijet dhe personalitetin e pedagogut, duke shprehur me kurajo e korrektesë mendimet e tyre në mënyrë adekuate brenda dhe jashtë auditorit.
- 6 . Të mos bëjnë sjellje te pahijshme ndaj stafit dhe studentëve të tjerë. Kritikrat duhet të jepen në një vend privat.
7. Të kuptojnë që çdo formë e shqetësimit lidhur me racën ,seksin, ngjyrën, fenë, moshën ,origjinën, kushtet shëndetësore konsiderohet jo etike.
8. Te respektojnë të drejtat dhe sigurinë e personave të tjerë në shkollë.
9. Te adresojnë mosmarrëveshjet ndërmjet shkollës dhe studentit tek një person përgjegjes, pa anashkalluar hallkat hierarkike të zgjidhjes së situatës.
10. Të vetëpërbahen ndaj çdo veprimi që mund të çënojë autoritetin e tyre.


Studentet nuk duhet të:

11. Zotërojnë apo të përdorin armë zjarri ose armë të ftohta brenda territorit të Universitetit.
12. Zotërojnë, të përdorin apo shesin në mënyrë ilegale droga brenda apo jashtë Universitetit.
13. Marrin pjesë në tentativa për mashtrim ose cënim të rregullave të procesit akademik.
14. Paraqesin punime të shkruara, laboratorike, apo projekte si të tija kur kanë dijeni se ato janë të një personi tjetër.
15. Të përvetësoj, të shkatërroj pronën e shkollës apo të dikujt tjetër .
16. Të bëjnë presion, të kërcënojë, të abuzojë ose sjellje të ngjashme me këto përkundrejt një personi, i cili është i ngarkuar me detyrën për t'i thënë këto para Këshillit të etikës.
17. Te fshehin prova ose të japë prova fallso rreth një ankese etike dhe profesionale, e cila është parë dhe hetuar.
18. Të veprojnë në një mënyrë, e cila indirekt interferon në mësimdhënien e shkollës, kërkimin apo administrimin e saj.

Paraqitja në shkollë, mirësjellja dhe respekti

Paraqitja e studentit në auditorë duhet të jetë përshtatshme dhe e tillë që të shprehë:

- a) kujdesin dhe seriozitetin e vazhdueshëm për anën tuaj pamore;
- b) nivelin e domosdoshëm të pastërtisë tuaj personale;
- c) plotësimin e kërkesave të domosdoshme të veshjes tuaj në ambientet e universitetit; Veshja e studentëve duhet të shfaqë seriozitetin e statusit dhe përputhje me qëllimin e pjesmarjes së studentit në procesin mësimor;
- d) vëmendje në mënyrën e komunikimit dhe të qëndrimit në ambientet e institucionit.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

PROÇEDURAT DISIPLINORE

Proçedurat disiplinore qeverisin disiplinën e çdo anëtari të komunitetit universitar që e rregullon Kodi i Etikës që akuzohen për shkeljen e këtij kodi dhe konsistojnë si më poshtë:

A. Ankesa

Ankesa është një shkresë që i drejtohet Kryetarit të Këshillit të Etikës pasi një shkelje e normave të Kodit të Etikës mund të jetë shfaqur dhe që Këshilli duhet ta shqyrtojë, por më parë Kryetari ngarkon të hetojë mbi këtë çështje një komision. Çdo i punësuar, student apo anëtar i shkollës mund të bëjë një ankesë. Ankesa duhet të raportohet si shkresë tek Kryetari i Këshillit të Etikës dhe ky ja përcjell atë Kryetarit të Komisionit të Incidenteve brenda dy javëve nga incidenti. Në këtë ankesë duhet të përshkruhen të gjitha faktet lidhur me shkeljen e normave të Kodit Etik. Gjatë kohës së hetimit mbi çështjen studentit apo çdo i punësuar në universitet, mund të mos përzulohet për vazhdimin e procesit mësimor apo programit shkollor.


B. Hetimi dhe sqarimi nga Komisioni i Incidenteve

Pasi merret ankesa e shkruar, Kryetari i Komisionit të Incidenteve brenda pesë ditësh pune do të:

1. Të fillojë hetimin me të paktën prezencën e tre anëtarëve të këtij Komisioni.
2. Të hartojë një shkresë të studentit apo të punësuarit në universitet të akuzuar me datën, kohën, vendin e incidentit, me dëshminë dhe evidencat përkatëse.
3. Dokumenti që i jepet anëtarit të komunitetit të universitetit të akuzuar gjithashtu duhet të përmbajë si më poshtë:
 - a. një shkresë të ankesës;
 - b. një shkresë e cila informon studentin që ai ose ajo mund të zgjedh prezencën ose jo të tij gjatë shkrimit;
 - c. Listën e dëshmitarëve të cilët do të parashtrojnë provat që mbështesin ankesën;
 - d. Listën e gabimeve nga ana e studentit apo të punësuarit nëse ai është fajtor.

Ankuesi i thirrur si dëshmitar do t'i paraqes komisionit në seancat e dëgjimit të dokumentave, prova ose dëshmitar të tjerë të cilët ai i mendon se kanë lidhje me ankesën që ka parashtruar.

Studenti apo i punësuar në këtë universitet ndaj të cilit është paraqitur ankesa, mund të mos ketë avokat prezent, por mund të ketë një anëtar të shkollës ose student tjetër në rolin e këshilltarit apo për mbështetjen emocionale. Ai mund të parashtrojë të gjitha provat, dëshmitaret apo dokumentacionin që janë në favor të tij Komisionit të Incidentit (KI). KI mund të pyesi të gjithë



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

dëshmitaret i pavarur nga rregullat e dëshmimeve që zbatohen normalisht në gjykimet që zhvillojnë gjykatat. Nuk mbahet protokoll, por sekretari i KI mund të shënojë disa gjëra të përmbledhura. Si përfundim KI i dërgon një rekomandim të shkruar kryetarit të Këshillit të Etikës dhe një votë mazhoritare është e mjaftueshme për të dalë në një përfundim.

Rekomandimet e mundshme të Komisionit të Incidenteve

1. Studenti nuk ka vepruar ose nuk ka dëshmi të mjaftueshme që ai ka vepruar në mënyrë jo etike.
2. Studenti ka vepruar në mënyrë jo profesionale dhe jo etike dhe ai duhet të këshillohet me Kryetarin e Këshillit të Etikës.
3. Studenti ka kryer një veprë jo etike dhe jo profesionale dhe kjo duhet t'i bashkangjitet dosjes së tij deri në diplomimin e tij.

Kryetari i Komisionit të Incidenteve në fund informon palën ankuese dhe të akuzuarin për shkresën e rekomanduar dhe kërkon prej tyre brenda shtatë ditëve një përgjigje nga pala e akuzuar e cila mund të jetë:


- a. pranojë rekomandimin nga KI
- b. apelojë për vendimin që është marrë nga KI.

Nëqoftëse ankuesi apelon Kryetari i Komisionit të Incidentëve i ngarkuar me sqarimin e ankesës do të procedojë duke e përcjellë atë së bashku me provat e mledhura në një proces gjykimi si më poshtë.

Gjykimi nga Këshilli i Etikës

Kryetari i KE njofton palët që të dorëzojnë një shkresë ku të jenë shkruar koha, data, vendi i dëgjimit dhe një kopje të ankesës. Seancat nuk do të zgjasin më shumë se 15 ditë nga skadimi i periudhës së apelimit kundrejt rekomandimit të KI. Gjatë seancave ankuesi apo i akuzuari mund të ketë një avokat prezent i cili nuk mund të veprojë si një këshillues për të interesuarin, i cili mund të parashtrijë të gjitha dokumentat apo dëshmitarët në favor të tij.

1. Gjykimi është një proces nga i cili mund të vendos me shumicë votash që mund të ketë ndonjë rekomandim ndaj atij ndaj të cilit është drejtuar ankesa për shkelje të normave të Kodit Etik.
2. Gjykimi duhet të ndahet në dy pista: **a.)** e para, një përkufizim që studenti apo i punësuar i që në universitet ka shkelur apo jo kodin; **b)** e dyta, një përkufizim për aktin apo gabimin përkatës.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS - FABREFACTA - OPTIME

3. I tërë Këshilli i Etikës duhet të votojë tek e tek në bazë të pyetjeve që bëhen dhe një votë mazhoritare vendos që ka pasur një shkelje të normave të Kodit apo duhet dërguar një rekomandim të KE.
4. Në përcaktimin e një faji Këshilli i Etikës mund të marr parasysh regjistrimet e mëparshme disiplinore që mund të ketë marrë studenti apo i punësuar në këtë universitet.
5. Nëqoftëse mazhoriteti i Këshillit të Etikës arrin në përfundimin se nuk përcakton që ka qenë apo jo një shkelje e normave të Kodit të Etikës apo të dërgohet apo jo një rekomandim për personin që shqyrtohet ankesa, nuk do të pasqyrohet ndonjë shënim në dosjen disiplinore të tij.
6. Si studenti apo i punësuar në këtë universitet që shqyrtohet për të cilin është paraqitur ankesa në Këshillin e Etikës të universitetit ashtu dhe avokati apo ndonjë person tjetër mbështetes nuk do të jenë prezent gjatë marrjes së vendimit të komisionit.

Rekomandimet

Çdo konkluzion që arihet pas dëgjimit dhe shqyrtimit të të gjitha provave verbale apo me shkrim nga Këshilli i Etikës që studenti apo i punësuar në universitet ka shkelur Kodin Etik apo akti përkates duhet të provohet nga KE, dhe do të merret një vendim, i cili do të pasqyrojë shkelje të Kodit Etik dhe provat që vërtetojnë atë. Brenda 10 ditësh nga marja dijeni për të mund të apelojë vendimin e marrë tek Dekani i Fakultetit përkatës.

Vendimet


1. Dekani duhet të jap vendimin përfundimtar, nëse kemi mosrespektim të normave etike të Kodit, ose mund të kërkojë prova të tjera për të ndihmuar në dhënien e këtij vendimi.
2. Nëqoftëse Dekani vendos që nuk ka ndonjë mosrespektim të normave etike të Kodit asgjë nuk duhet shënuar në dosjen disiplinore të studentit.
3. Studenti apo i punësuar në këtë universitet, që ka qenë thirrur nga Këshilli i Etikës për ankesën që është bërë ndaj tij, për shkelje të normave të etikës, duhet të informohet mbi vendimin që ka marrë Dekani brenda 10 ditëve pasi ai ka apeluar për vendimin e marrë nga KE.

Apelimi

Apelimi për vendimin e marrë nga Dekani brenda 5 ditëve pas daljes së vendimit, duhet të përfshij ndonjë dëshmi apo material jo i dhënë më parë. Dekani merr një vendim final pas 10 ditësh pune nga apelimi i ankuesit.

AKTET DHE GABIMET

Aktet dhe gabimet e rekomanduara KE dhe të vendosura nga Dekani duhet të jenë të përshtatshme dhe logjike.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

Këto janë:

KËSHILLIMI

Studenti do të këshillohet nga anëtarët e Komisionit ose nga persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni. Këshillimi nuk konsiderohet si një dënim ose faj dhe nuk shënohet në dosjen disiplinore të studentit. Ai vlen që t'i paraprihet një shkelje të normave të Kodit Etik .

PËRSËRITJA E PROVIMIT

Studentit do t'i kërkohet të përsëritet provimi apo ndonjë procedurë tjetër në lidhje me shkeljen e normave të Kodit. Këto mund të shënohen në dosjen disiplinore të studentit por mund të fshihen pas diplomimit të tij dhe nuk jepen si referencë për studentin.

LETËR E PËRKOHSHME QORTIMI

Studenti do të marrë një qortim të shkruar nga Këshilli i Etikës, firmosur nga Kryetari. Një kopje e saj do t'i bashkangjitet dosjes së studentit. Kjo nuk jepet si referencë pas diplomimit dhe fshihet nga dosja vetëm nëse student i pas kësaj nuk ka kryer ndonjë shkelje tjetër të Kodit.

SHKRESË QORTIMI

Studenti do të marrë një shkresë qortimi nga Komisioni e firmosur nga Kryetari. Kjo i bashkangjitet dosjes dhe i jepet si referencë nga shkolla pas diplomimit.

PËRSËRITJE SEMESTRI


Studentit i kërkohet të përsërisë semestrin apo vitin nëqoftëse brenda kësaj kohe ai ka kryer ndonjë shkelje të normave të Kodit Etik. Ky akt regjistrohet në dosjen permanente të studentit dhe i jepet si referencë pas diplomimit.

ZHDËMTIMI

Në qoftë se student i dëmton ndonjë objekt që i përket universitetit, ai duhet ta zhdëmtojë atë brenda një kohe të përcaktuar. Kjo shënohet në dosje dhe referohet pas mbarimit të shkollës.

PËRJASHTIMI ME MUNDËSI RIAPLIKIMI

Studenti pezullohet nga programi dhe mund të lejohet të aplikoj përsëri vitin tjetër, por kjo gjë shënohet në dosjen e tij dhe referohet pas shkollës.



ALBANIAN UNIVERSITY
UNIVERSITAS- FABREFACTA-OPTIME

PËRJASHTIMI PËRGJITHMONË

Studenti pezullohet nga vazhdimi i programit dhe nuk lejohet më të aplikoj në shkollën tonë, i propozohet nga Dekani i Fakultetit mbështetur në nenin 39/a të Rregullores së “Albanian University”.

BURIMET E SHFRYTËZUARA

- Statuti “Albanian University”
- Rregullorja e Institucionit “Albanian University”
- Kodi Etik “Albanian University”